

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.139, datë 23.12.2022

PËR

**“DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.158, DATË 26.12.2019, TË KËSHILLIT
BASHKIAK, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË
QYTETIN E TIRANËS”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1, shkronjat “c” dhe “ç”, dhe pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja “b”, nenit 34, pika 4, nenit 54, shkronja “f” dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar dhe memos drejtuar Kryetarit të Bashkisë nr. 24300 prot., datë 01.07.2022 “Mbi taksën e përkohshme të infrastrukturës arsimore”, me propozim të kryetarit të Bashkisë, këshilli bashkiak,

V E N D O S I :

1.Në vendimin nr. 158, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, të ndryshuar”, Titulli I, Kreu X, ndryshohet si më poshtë:

Neni 36

Subjektet dhe niveli taksës

1. Taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore i nënshtrohen të gjitha familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike, në njësi fikse të palëvizshme, brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.
2. Niveli i taksës së përkohshme të infrastrukturës arsimore është si më poshtë:
 - i. Për kategorinë “Familjarë” niveli i taksës është 1,800 lekë në vit por jo më shumë se 35% e vlerës së taksës mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesë”.
 - ii. Për kategorinë “Biznesi”, niveli i taksës së përkohshme të infrastrukturës arsimore, është sipas kategorive dhe nënkategorive, në Aneksin nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi por jo më shumë se 35% e vlerës të taksës mbi pasurinë e paluajtshme, ku ushtrohet aktiviteti ekonomik i subjektit.Taksës së përkohshme të infrastrukturës arsimore i nënshtrohen të gjithë subjektet e kategorisë “Biznesi”, pavarësisht nëse janë ose jo subjekt i taksës mbi pasurinë e paluajtshme.
 - iii.Nivelet e përcaktuara sipas Aneksit nr.5 bashkëngjitur të aplikohen deri ne momentin e verifikimit të vlerës së pasurisë së paluajtshme. Në rastet kur, pasuria e paluajtshme ku ushtrohet aktiviteti, është e pamundur të identifikohet apo të vlerësohet, niveli i taksës do të aplikohet sipas Aneksit nr.5.

- iv. Të ardhurat e arkëtuara nga taksa e infrastrukturës arsimore do të përdoren vetëm për infrastrukturë arsimore, për implementimin e “Planit të investimeve nga të ardhurat nga Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore”, sipas Aneksit nr. 1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 37

Mënyra e pagesës

1. Detyrimi për taksën e përkohshme për infrastrukturën arsimore është vjetor. Kjo taksë aplikohet për një periudhë 3-vjeçare, 2023-2025, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
2. Për kategorinë I “Familjarët” detyrimi paguhet në 12 këste të barabarta, për çdo muaj. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit. Likuidimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit.
3. Për kategoritë II. “Biznesi” detyrimi paguhet brenda datës 20 Prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

Neni 38

Lehtësira dhe përjashtime

1. Në kategoritë e përjashtuara nga pagesa e taksës së përkohshme e infrastrukturës arsimore, përfshihen pensionistët, veteranët, invalidët e punës e luftës, përfituesit e ndihmës ekonomike, të verbrit, të sëmurët tetraplegjik dhe paraplegjikë, si dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuara, sipas përkufizimit të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
2. Kategoritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, për të përfitur këtë përjashtim, duhet të dorëzojnë pranë zyrave të Njësive Administrative dhe Lagjeve të Bashkisë së Tiranës:
 - a. Dokumentin që vërteton kushtin që sipas certifikatës familjare janë kryefamiljarë dhe pa persona të tjerë madhorë përveç bashkëshortit ose bashkëshortes, si dhe personave të tjerë madhorë të paafte për punë (invalidë ose fëmijë nën 25 vjeç që ndjekin studimet).
 - b. Librezën e veteranit ose invalidit të luftës, statusin e invalidit të punës e të luftës, statusin e të verbrit, të sëmurëve paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit, vërtetimin e KMCAP, vërtetimin nga Njësia Administrative/lagjet për përfituesit e ndihmës ekonomike.
3. Nga taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore, përjashtohen administratorët e pallateve dhe individët fermerë.
4. Nga taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore përjashtohen edhe të gjithë niptet sekondare të regjistruara nga subjektet taksapagues për efekt të detyrimeve tatimore apo sigurimeve shoqërore dhe që nuk janë njësi fikse dhe të palëvizshme.
5. Përjashtimin nga pagesa e taksës së përkohshme të infrastrukturës arsimore për të gjithë adresat sekondare të regjistruara në QKB në datën 26.09.2019 me përshkrimin “Burim fshati”, “Depo uji” dhe “Stacion pompimi”, etj në pronësi të Ujësjetës Kanalizime Tiranë sha.
6. Përjashtimin nga taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore në masën 50% për bizneset e ngritura nga romët dhe egjiptianët dhe për ato biznese, të cilat numri i të punësuarve romët dhe egjiptianë zënë mbi 30% të numrit total të të punësuarve në atë biznes.

Neni 39

Mënyra e përlllogaritjes

1. Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer, përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

2.Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO

Aneksi nr. 5: Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore për kategoritë e Biznesit

	Kategorite	BV		BM	VIP
		0-2 milionë	2-8 milionë		
		Leke /vit		Leke /vit	Leke /vit
1	Shitje me pakicë	2,500	4,000	15,000	22,000
2	Shitje me shumicë	8,000	9,000	27,000	37,000
3	Njësi prodhimi	8,000	9,000	27,000	37,000
4	Subjekte ndërtimi	8,000	9,000	27,000	37,000
5	Njësi shërbimi	2,500	4,000	17,000	32,000
6	Shoqata, fondacione, ente të ndryshme, shtetërore, organizata jofitimprurëse	5,000			
7	Profesione të lira	2,500	4,000	15,000	18,000
8	Transport	2,500	4,000	11,000	18,000